



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS KLINË

Numri i lëndës: 2023:077289

Datë: 19.04.2024

Numri i dokumentit: 05597426

P.nr.53/2023

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA NË KLINË, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal, Gjyqtarja e vetme gjykuese Sabrije Rraci, në çështjen penale kundër të pandehurve V (B) G, nga fsh. Q. K. K, i akuzuar për shkak të kryerjes së veprës penale „Sulmi” nga neni 184 par. 1 të KPRK-së, dhe i pandehuri V (N) E nga K, Rr. „A. R” i akuzuar për shkak të veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par. 2 pika 1.4 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë, nr PP//II.nr.135/2023, të datës 24.03.2023, në shqyrtimin fillestar publik të mbajtur me dt. 2819.03.2024 në praninë e Prokurorit të Shtetit Ramiz Buzhala nga Prokuroria Themelore në Pejë, dhe të pandehurve V. G dhe V. E dhe mbrojtësit të V.E. të caktuar EX officio, av. Shaban Shala, si dhe të dëmtuarit A. R, pas përfundimit të shqyrtimit fillestar me datë 10.03.2024, të njëjtën ditë gjykata shpalli aktgjykimin, ndërsa me datë 19.04.2024, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

Kundër:

1.V. G, i lindur me datë, në fshatin Q, K. K, nga i ati S, e ëma B, e vajzërisë G, tani me vendbanim në fshatin Q. K. K, posedon numër letërnjoftimi, ka të kryer shkollën e mesme, i martuar, i gjendjes së mesme ekonomike, me profesion punëtor, posedon numër telefoni, i nacionalitetit shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, ka qenë i ndaluar për 48 orë, mbrohet në liri,

2.V. E, i lindur datë me, në fshatin D. K. K nga i ati N, e ëma V, e vajzërisë U, tani me vendbanim në, Rr. "A. R", K. K posedon numër letërnjoftimi....., ka të mbaruar shkollën e mesme, student, i gjendjes së mesme ekonomike, i pa punë, posedon numër telefoni, i nacionalitetit shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, ka qenë i ndaluar për 48 orë, mbrohet në liri,

JANË FAJTOR

Për shkak se:

I pandehuri V. G:

I.Me datë, rreth orës, në rrugën "S. R", K. K, pikërisht tek lokali "B", me dashje përdor forcën ndaj personit tjetër dhe atë ndaj të dëmtuarit A. R, në atë mënyrë që, përderisa i dëmtuari ka qenë duke qëndruar në lokalit e lartcekur në një tavolinë me të pandehurin, i pandehuri pas një mosmarrëveshje verbale me të dëmtuarin tjetër R R, ngritët në këmbë duke u nisur në drejtim të tij, ku aty i dëmtuari A në tentim e sipër që t'i ndaj të njëjtit, i dëmtuari A goditet me grushte në fytyrë nga i pandehuri V.

- me çka ka kryer veprën penale "Sulmi" nga neni 184 par. 1 të KPRK-së.

I pandehurit V. E:

II. Me dt....., rreth orës në rrugën "S. R", K. K, pikërisht tek lokali "B", me dashje dhe me mjetë të përshtatshëm për shkaktimin e lëndimit të rëndë trupor, i shkakton lëndime të lehta trupore me pasoja të dëmtimit të përkohshëm të shëndetit dhe atë të dëmtuarit R. R në atë mënyrë që, përderisa i dëmtuari ka qenë në vendin e lartcekur i ulur në njërin nga tavolinat e lokalit, pas një fjalosje verbale, aty shkon i pandehuri V dhe e godet me shishe xhami në kokë, e si pasojë e këtyre goditjeve, sipas ekspertizës mjeko ligjore të punuar për rastin, të dëmtuarit i shkaktojnë lëndime të lehta trupore, me dëmtim të përkohshëm të shëndetit, me konkretisht të përshkruara si në ekspertizën mjeko ligjore.

- me çka ka kryer veprën penale "**Lëndim i lehtë trupor**" nga neni 185 par. 2 lidhur me par. 1 nën par. 1.4 të KPRK-së.

Për shkak se:

Prandaj gjykata në bazë të neneve 4, 7, 17, 38, 48, 47 dhe 69 dhe 70 dhe nenit 185 par. Lidhur me par 1.1.4 par.1 të KPRK-së, dhe nenit 184 par. 1 të KPRK-së si dhe nenit 364 të KPPRK-së i:

GJYKON

DËNIM ME KUSHT

1.Të pandehurin V. G, me dënim me burgim në kohëzgjatje prej katër (4) Muaj i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri në periudhën verifikuese prej një (1) viti, nuk kryen vepër të re penale.

II. Dënimi me kusht do t'i revokohet nëse i pandehuri kryen vepër penale brenda periudhës verifikuese prej 1 (një) viti, konform nenit 50 të KPRK-së.

2.Të pandehurin V. E, me dënim me burgim në kohëzgjatje prej shtatë (7) Muaj i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri në periudhën verifikuese prej një (1) viti, nuk kryen vepër të re penale.

II. Dënimi me kusht do t'i revokohet nëse i pandehuri kryen vepër penale brenda periudhës verifikuese prej 1 (një) viti, konform nenit 50 të KPRK-së.

III.OBLIGOHEN: të pandehurit secili veq e veq, qe në emer të paushallit gjyqësor të paguajnë nga 20 (njëzet) €, si dhe për tarifën për kompensim të viktimave të krimit secili nga 20 (njëzet) €, të gjitha këto në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh, pasi aktgjykimi të merrë formën e prerë.

Udhëzohet: I dëmtuari A (S) R dhe R (S) R, qe të dy nga Klina, rr. „A. Z”, qe kërkesën pasurore juridike ta realizoi në kontest civil.

A r s y e t i m

1.Ecuria e procedurës penale

Prokuroria Themelore në Pejë- Departamenti i Përgjithshëm, pranë kësaj gjykate ka paraqitur aktakuzën, me shenjën nr PP//II.nr. 135/2023 të datës 24.03.2023 ndaj të pandehurve V (B) G, nga fsh. Q, K, K, i akuzuar për shkak të kryerjes së veprës penale „Sulmi” nga neni 184 par. 1 të KPRK-së, dhe i pandehuri V (N) E nga K, Rr.

„A. R” i akuzuar për shkak të veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.
2 pika 1.4 të KPRK-së

Gjykata mbajti seancën e shqyrtimit fillestar me dt.19.03.2024, gjatë të cilës u dëgjuan
Prokurori i Shtetit, Ramiz Buzhala i akuzuari V. G dhe V. E dhe mbrojtësi av. Shaban
Shala, dhe i dëmtuari A (S) R.

Pas leximit të aktakuzës nga prokurori i shtetit, i pandehuri:

1.V. E pas konsultimit paraprak të mbrojtësit të tij, ka deklaruar se e pranon fajësinë për
veprën penale që i vihej ne barre, me vie keq për këtë që kam bërë, dhe i njëjti deklaroi
se pendohem për veprën penale të kryer. I njëjti deklaroi se me palën e dëmtuar R. R
jemi pajtuar dhe tani më nuk kemi asgjë të keqe.

2.V. G ka deklaruar se e pranon fajësinë për veprën penale që i vihej ne barre, me vie
keq për këtë që kam bërë, jam i penduar thellë dhe i njëjti i kërkon falje publike palës së
dëmtuar A. Rr i cili është prezent në seancë.. I njëjti deklaroi se me palën e dëmtuar R.
R jemi pajtuar dhe tani më nuk kemi asgjë të keqe.

Gjykata kërkon mendimin e prokurorit të shtetit lidhur me pranimin e fajësisë nga ana
e të pandehurit.

Prokurori i Shtetit ka deklaruar se pasi që dy të pandehurit V. G dhe V. E e pranuan
fajësinë dhe ky pranim i fajësisë është bërë me vullnet të lirë dhe pa presion, duke u
mbështetur në provat materiale që gjenden ne shkresa të lënda. I propozoj gjykatës që
të pranoj pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit për veprën penale që i vihet ne
barre, dhe me rastin e marrjes së vendimit, lidhur me dënim, pranimin e fajësisë ta
vlerësoj si rrethanë lehtësuese.

I dëmtuari A. Rr deklaroi jemi pajtuar ne mes vete, dhe me këtë rast unë ua kam falur
sipas traditave zakonore nuk kërkoje ndjekje penale as kërkesë pasurorë juridikë.
Mbrojtësi i të pandehurit.

Mbrojtësi i të pandehurit V. E, Av Shaban Shala ka deklaruar se pajtohem me pranimin e fajësisë të mbrojtur tim të cilin këtë pranim e beri me vetëdije të plotë pa imponim nga jashtë, i njëjti ka deklaruar se palës së dëmtuar i ka kërkuar falje sipas traditës me të njëjtin janë pajtuar dhe rasti ka ngjare pa qellim të caktuar por në ndikim të alkoolit e që të sikur të mos kishte ndikuar alkooli në të, atë veprim nuk do ta kishte bërë në asnjë mënyrë, premtori se në të ardhmen nuk do të kryej vepra të tilla është i penduar për vepra të tilla, dhe për këtë arsyeje i propozojmë gjykatës që me rastin e vendosjes si rrethane lehtësuese ta marrë parasysh pranimin e fajësisë kërkimin falje dhe pajtimin me familjen e të dëmtuarit, është hera e parë që ka rënë ndesh me ligjin, dhe me rastin e vendosjes për përgjegjësinë dhe sanksionin të njëjtit të shqiptoj në dënim sa më ulët në minimumin përparë me logje mundeshit me gjore apo të kushtëzuar me qene se i njëjti është student dhe me ndonjë vendim të mos pengohet vijimi rregullt në ligjëratat dhe dhënien e provimeve.

Po ashtu edhe mbrojtësi i të pandehurit V. E, av. Shaban Shala, ka deklaruar se pas konsultimit paraprak me të mbrojtur tim, kërkoj nga gjykata që të këtë lehtësira, me rastin e marrjes së vendimit, duke pas parasysh se i pandehuri nuk është në marrëdhënie pune, nuk ka dëshmi se ka kryer vepra tjera. Duke e marrë parasysh se vetë e ka dorëzuar armën-pushkën e gjuetisë, kërkoj nga gjykata që me rastin e marrjes së vendimit të këtë parasysh gjendjen e dobët ekonomike dhe të shqiptoj një dënim më të butë.

2. Vlerësimi i pranimit të fajësisë

Në shqyrtimin fillestar dhe publik, gjykata, pas dëgjimit të palëve, ka marrë aktvendim me të cilin e ka pranuar fajësinë nga i akuzuari i lartcekur, për veprën penale për të cilën është ngarkuar, ngase ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore nga neni 242 të KPPK-së. Në këtë aspekt gjykata, ka konstatuar se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë dhe pas njoftimit nga ana e gjykatës lidhur me benifitet dhe pasojat e pranimit të fajësisë, ka vlerësuar se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga i akuzuari, se pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

3. Gjendja faktike e vërtetuar:

Andaj duke u bazuar në këto që u cekën më lartë, gjykata, e ka vërtetuar këtë gjendje faktike: Se te akuzuarit, kane kryer veprën penale, mbajtje në pronësi kontrollë ose posedim i paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

4. Vendimi për shpalljen fajtor

Duke u bazuar në këto që u cekën më lart, gjykata, ka vendosur që të akuzuarit, t'i shpalli fajtor për kryerjen e veprave penale sipas aktakuzës së cekur më lart, meqenëse është vërtetuar se të njëjtit e kane kryer veprën penale siç edhe vet e ka pranuar sikurse në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar sikurse në dispozitiv të aktgjykimit dhe për të njëjtën është përgjegjës. Kjo për faktin se e ka pranuar edhe vet.

5. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit:

Me rastin e shqiptimit të dënimit ndaj të akuzuarës Gjykata, i ka marrë për bazë të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, sipas neneve 69 dhe 70 të KPK-së.

Në këtë aspekt, si rrethanë lehtësuese, mbi bazën e së cilës gjykata e ka shqiptuar dënimin për veprën penale sikurse më lart, është fakti se i akuzuari V. E e ka pranuar fajësinë në shqyrtimin fillestar dhe pendimin e tij, padënueshmërinë e tij më parë, si rrethanë tjetër lehtësuese gjykata muar se i pandehuri është pajtuar me palën e dëmtuar sipas traditave zakonore, ashtu që gjykatës i ka premtuar se nuk do ta përsërisë më vepra penale. Ndërsa, gjykata sa i përket rrethanave rënduese gjykata ka gjetur dashjen e kryerjes së veprës penale.

Në këtë aspekt, si rrethanë lehtësuese, mbi bazën e së cilës gjykata e ka shqiptuar dënimin për veprën penale sikurse më lart, është fakti se edhe i pandehuri V. G, është deklaruar se e pranon fajësinë për veprën penale që i vihet në barrë, i pandehuri i kërkon

falje publike të dëmtuarit i cili ka qenë prezent në seancë, i premtos gjykatës se nuk do të përsërisë vepra të tilla apo të ngjajshme penale.

6. Shqiptimi i dënimit në harmoni me peshën e veprës penale dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit dhe qëllimi i dënimit të shqiptuar.

Andaj duke i marrë për bazë rrethanat e përmendura më lartë, është dënim i drejt, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale për dy të akuzuarit.

Gjykata ka konstatuar se me këto dënime mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit, nga neni 38 i KPRK-së, i cili konsiston në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tyre, por edhe (për mundësinë që të kthehet në një element kontribues për vete, familjen dhe për rrethin ku jeton) të parandaloj personat tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimi për shpenzimet e procedurës dhe paushallit gjyqësor është i bazuar në nenin 449 par. 2 pika 2.6 të KPPK-së, ndërkaq vendimi për pagesën në Fondin për Kompensimin e Viktimave të Krimit është i bazuar në nenin 36 par. 3 nënpar. 3.1 të LKVK-së.

Nga arsyet e cekura më lartë e në bazë të neneve 242 dhe nenit 364 dhe KPPRK-së është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË-DEGA KLINË

DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM

P.nr.53/2023 me datë 11.03.2024

Gjyqtarja
Sabrije Rraci

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi palët kanë te drejte te parashtrojnë ankesë në afat prej 30 ditësh, nga dita e marrjes. Ankesa i dërgohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë përmes kësaj Gjykate.